



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

MINISTRIA E DREJTËSISË  
Nr. 4034 Prot.  
Datë, më 19.06.2023.

V E N D I M

Nr. 362, datë 16.6.2023

P Ë R

**NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.718, DATË 29.10.2004,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE  
TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT",  
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr.157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit ("Lista e OKB-së"), që i bashkëlidhet vendimit nr.718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet shtesa, me këtë përmbajtje:

Në listën e shkronjës "C", të titulluar "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (*Da'esh*) dhe *Al-Qaida*", shtohen dy individë të renditur në shkronjën "a", sipas shtesave që i bashkëlidhen këtij vendimi, në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për

personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatave ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**


MINISTRI PËR EVROPËN  
DHE PUNËT E JASHTME

**OLTA XHAÇKA**

Në mungesë dhe me porosi

**ZËVENDËSMINISTRI**

**ARTEMIS MALO**



**PËRDITËSIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI  
FINANCUES TË TERRORIZMIT**

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT  
("LISTA E OKB-së")

**C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME  
ORGANIZATAT ISIL (*Da'esh*) dhe *Al-QAIDA***

**a) Lista e shtuar në "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë  
me organizatat ISIL (*Da'esh*) dhe *Al-Qaida*";**

1. ABDULLAHI; OSMAN; MOHAMED; CADDOW
2. MERAL; ABDEFATTAH; KHALIL; ZOGHBI

Shënim: Gjeneralitetet e tjera për personin, emri i të cilit është radhitur më sipër,  
mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.



NR.PROT. 2731/1  
DATË 19. 6. 2023

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË  
MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E  
JASHTME  
MINISTRISË SË DREJTËSISË  
MINISTRISË SË BRENDSHME  
PROKURORISË SË PËRGJITHSHME  
SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT  
BANKËS SË SHQIPËRISË  
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjell AGACI**

